

**BASHKIA TIRANË**

## NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E KONTRATËS GJATË ZBATIMIT

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Bashkia Tiranë  
Adresa Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë  
E-mail administrative.prokurime@tirana.al  
Adresa e Internetit www.tirana.al

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri M.K  
E-mail administrative.prokurime@tirana.al

3. Lloji i procedurës së prokurimit: Proçedurë e hapur

4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes kuadër: Shërbim

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: REF-55522-12-29-2022.

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Sistemi Elektronik për të ruajtur, menaxhuar dhe ndjekur në formë elektronike informacionin e bazuar në dokumenta zyrtarë (Letër)”.

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Shërbim programimi për aplikacione 72212000-4.

8. Fondi limit: 29,166,665 (njëzet e nënëtë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lek pa tvsh, i përbërë nga dy vlera që u përkasin dy llogarive të ndryshme, respektivisht llogarisë për investime dhe asaj për shpenzime korrente, si më poshtë vijon:

- Sistemi elektronik për të ruajtur, menaxhuar dhe ndjekur në formë elektronike informacionin e bazuar në dokumenta zyrtarë( letër)” në programin buxhetor “Investim (231)” me vlerë të fondit limit 25.000.000 (njëzetë e pesë milion) lekë pa tvsh
- Sistemi elektronik për të ruajtur, menaxhuar dhe ndjekur në formë elektronike informacionin e bazuar në dokumenta zyrtarë( letër)” në programin buxhetor “Shpenzime operative (602)” me tipologji (mirëmbajtje dhe trajnime) me vlerë të fondit limit 4.165.665 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh.

9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë: Modifikimi kryhet në përputhje me nenin 127 pika 1 gërma (c) të ligjit nr 162//2020 për “Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe nuk ndodhet në kushtet e nenit 127 pika 4 e ligjit Nr.162/2020 për “Prokurimin Publik” pasi nuk kemi të bëjmë me modifikim të një kushti thelbësor të kontratës. Në datë 08.04.2024 pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, është paraqitur shkresa me Nr.14280/1 prot nga Drejtoria e Përgjithshme e Qeverisjes Elektronike dhe Inovacionit me anë të së cilës kërkohet ”Shtyrja e afatit të përfundimit të shërbimit në objektin: “Sistemi Elektronik për të ruajtur, menaxhuar dhe ndjekur në formë elektronike informacionin e bazuar në dokumenta zyrtarë (Letër)”. Bashkia Tiranë ka nënshkruar kontratën Nr. 3324/5 prot., datë 07.03.2023, me objekt: “Sistemi Elektronik për të ruajtur, menaxhuar dhe ndjekur

në formë elektronike informacionin e bazuar në dokumenta zyrtarë (Letër)”, me Operatorin Ekonomik “BNT ELECTRONICS” sh.p.k.

Ky projekt në fillimet e tij, ndër të tjera ka synuar:

- Ndërtimin e një sistemi elektronik në funksion të digjitalizimit të procesit të arkivimit të dokumentave shkresor të Bashkisë së Tiranës.
- Furnizimin e hardëare në funksion të projektit.
- Shërbimin e skanimit të 2.000.000 ( dy milion) dokumentave ekzistuese në Institucion.
- Trajnim dhe ngritje të kapaciteteve të stafit të Bashkisë së Tiranës.

Prej nënshkrimit të kontratës më datë 07.03.2023 e cila është dhe data data e hyrjes në fuqi të saj, Operatori Ekonomik ka filluar me zbatimin sipas kërkesave të termave të referencës, pjesë e Dokumentave Standarte të Tenderit. Përgjatë 3 (tre) muajve të parë është realizuar zhvillimi i sistemit me të gjithë komponentët përbërës të tij, furnizimi, instalimi, konfigurimi dhe intergimi e pajisjeve hardëare si dhe për trajnimin e përdoruesve fundorë dhe administratorëve teknik të sistemit.

Pasi të gjithë proceset dhe funksionalitetet u testuan dhe u provuan, u bë dorëzimi final i sistemit më datë 07.06.2023, datë kjo e cila përkon dhe me fillimin e shërbimit për fazën 7 “Skanimi dhe regjistrimi i dokumentacionit ekzistues”. Kjo fazë, sipas afateve të ekzekutimit të kontratës ishte parashikuar të realizohej për një periudhë prej 10 muajsh dhe pritej të përfundonte më datë 07.04.2024, ditë e diel.

Bazuar në pikën 4 të nenit 56 ‘Llogaritja e afateve’, të ligjit nr. 44/2015 ‘Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë’, ku citohet: ‘Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj.’, data e përfundimit të ekzekutimit të fazës 7 “Skanimi dhe regjistrimi i dokumentacionit ekzistues” është data 08.04.2024.

Deri në këtë datë, numri i fletëve të skanuara është 1,798,600 (një milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind), 201,400 (dyqind e një mijë e katërqind) fletë më pak sesa është parashikuar në kontratë.

Përsa më sipër, më datë 08.04.2024, Operatori Ekonomik “BNT ELECTRONICS” sh.p.k, ka adresuar pranë Bashkisë së Tiranës, shkresën me nr. 14280 prot., datë 08.04.2024, me objekt: “Kërkesë për shtyrjen e afatit të Kontratës nr. 3324/5 prot., datë 07.03.2023 për fazën 7 “Skanimi dhe regjistrimi i dokumentacionit ekzistues”, në të cilën kërkohet : ‘...shtyrjen e kësaj faze me një afat shtesë me 5 ditë pune...’ me arsyetimin si më poshtë:

Per fazen e shtate te ketij projekti “Skanimi dhe regjistrimi i dokumentacionit ekzistues” kontraktori BNT Electronics ka parashikuar realizimin e tij nga muaji i katert te implementimit te kontrates deri ne muajin e trembedhete, duke nisur nga data 07.06.2023 deri me daten 06.04.2024.

Kontraktori duke patur parasysh sfiden per realizimin ne kohe te projektit per shkak te ngarkeses se skanimit dhe dixhitalizimit parashikuar ne DST, ne moment te zhvillimit te procedures ka ofertuar dhe ka hartuar dokumentin titulluar “Oferta Teknike” (dokument I ngarkuar nga ana e tij ne SPE), mbi bazen e llogaritjeve ditore ekzakte si dhe duke patur parasysh festat zyrtare te vitit 2023 publikuara ne ate moment nga Banka e Shqiperise, ne faqen [https://www.bankofalbania.org/Shtypi/Kalendari\\_i\\_festave\\_zyrtare\\_2023/](https://www.bankofalbania.org/Shtypi/Kalendari_i_festave_zyrtare_2023/).

Per kete arsye, festat zyrtare te levizshme (sic jane disa prej festave fetare psh. E diela e Pashkeve Katolike) ose pushimet zyrtare te miratuara me VKM kane qene te paparashikuara nga ana e tij ne momentin e hartimit te dokumentit “Oferta Teknike” dhe perbejne nje shkak kryesor per pamundesine e perfundimit ne kohe te kesaj faze dhe si pasoje ka kerkuar shtyrjen e kesaj faze me nje afat shtese me 5 dite pune. Duke qene se ne Bashkine Tirane kane ngelur ende 201,400(dyqind e njemije e katerqind) faqe dokumentash pa u skanuar kontraktori ka gjykuar se koha e kerkuar eshte e mjaftueshme per realizimin me suksese te kesaj faze kontraktore.

Si me poshte paraqitet kalendari i festave zyrtare te cilat u ben shkas per daljen jashte parashikimeve per realizimin ne kohe te fazes se 7 te kontrates:

- 27.11.2023 VKM nr. 652 date 22.11.2023 (e hene);
- 15.03.2024 VKM nr. 156, datë 13.3.2024 (e premte);
- 31.03.2024 E diela e Pashkëve Katolike shtyre per 01.04.2024 (e hene).

Shkaku kryesor per daljen jashte parashikimeve kohore kane qene festat fetare te cilat si rregull konsiderohen si festa te levizshme si dhe pushimet e miratuara me VKM, per te cilat kontraktori nuk ka qënë ne dijeni as nuk kishte sesi te parashikonte vonesat. Gjithashtu, duke marr shkas dhe nga rrethana teper te rendesishme si me poshte:

Per cdo dokument qe regjistrohet ne sistem, plotesohen te dhenat ne lidhje me fushat me poshte:

- Data e dokumentit shkresor
- Kategoria (lloji dokumentit)
- Dërguesi
- Marrësi
- Lënda
- Numri i Protokollit
- Punonjësi që po regjistron dokumentin shkresor
- Koment

Gjate procesit te skanimit dhe digitalizimit te arkives te Bashkise Tirane ,janë hasur problematikat e meposhtme te cilat kane ndikuar ne vonesa ne procesin e skanimit , ku nder te tjera mund te permendim :

1. Per cdo dokument qe regjistrohet ne sistem duhet te ruhen metadata ne lidhje me lenden e dokumentit, e cila ne pjesen me te madhe te rasteve eshte e gjate dhe perbehet nga disa rreshta ( 3-9 rreshta e gjate) , duke sjelle vonesa ne procesin e skanimit.
2. Identifikimi i llojit te shkresave – diversiteti i llojeve te ndryshme te shkresave qe ka ne arkiven fizike te Bashkise Tirane , e ben me te veshtire identifikimin e tyre per te percaktuar se ne cilen klase dokumentash duhen regjistruar.
3. Kompleksiteti i permbajtjes – prane arkives se BT ka dokumenta qe kane materiale delikate qe kerkojne me shume kohe per proceduren e skanimit.
4. Diversiteti i llojeve te dokumentave brenda nje dokumenti ose brenda te njejtës dosje. Kemi patur plot raste qe ne nje dosje , kishte dokumeta A3, A4 dhe A0 , gje qe sjell kohe dhe vonesa ne procesin e skanimit.
5. Dokumentat e printuar nga te dyja anet – Ka patur plot raste ku dokumentat e arkivuar kane informacion te printuar nga te dyja anet e fletes , ku pavaresisht faktit qe llogaritet si nje flete e vetme , rrit kohen per skanimin e dokumentacionit.
6. Kontrollat e Cilesise – cdo dite kryhen kontrole cilesie ku verifikohen numri dhe cilesia e dokumentave te skanuar, konvertimi i tyre ne searchable pdf, gje e cila vonon procesin e skanimit te dokumentacionit

Rrethana faktike dhe kumulative per te cilat vonesa ne realizimin ne kohe te fazes se shtate do te ishin te pashmangshme, pasi planifikimi per realizimin ne kohe te kesaj faze eshte bere gjithmone duke llogaritur afate per te cilat kishte mundesi per tu parashikuar.

Komisioni i ngritur sipas Urdhrit të Titullarit me nr. 21432 prot., datë 07.06.2023, “Për ngritjen e komisionit për verifikimin dhe marrjen në dorëzim të shërbimit të skanimit e rregjistrimit të dokumentacionit ekzistues si dhe shërbimit të mirëmbajtjes në zbatim të kontratës nr. 3324/5 prot.,

datë 07.03.2023, me objekt “Sistemi elektronik për të ruajtur, menaxhuar dhe ndjekur në formë elektronike informacionin e bazuar në dokumenta zyrtarë (letër)”, pasi mori në shqyrtim kërkesën e sipërcituar dhe pasi analizoi arsyetimin e Operatorit Ekonomik mbi shtyrjen e afatit të kontratës për fazën 7 “Skanimi dhe regjistrimi i dokumentacionit ekzistues”; gjykoji të arsyeshme të marrë në konsideratë këtë kërkesë për zgjatjen e kohës së realizimit të shërbimit.

Në përmbledhje të sa më sipër dhe bazuar në Nenin 21 ‘Modifikimi i Kontratës’, Nenin 22 ‘Zgjatja e Afatit’, të kontratës së sipërcituar dhe duke marrë në konsideratë rëndësinë që ka realizimi i këtij shërbimi për Autoritetin Kontraktor, Struktura e cila ndjek edhe menaxhon këtë kontratë kërkoi zgjatjen e afatit me 5 (pesë) ditë pune, për fazën 7 “Skanimi dhe regjistrimi i dokumentacionit ekzistues”, të kontratës me objekt “Sistemi Elektronik për të ruajtur, menaxhuar dhe ndjekur në formë elektronike informacionin e bazuar në dokumenta zyrtarë (Letër)” duke filluar nga data 08.04.2024 me përfundim data 15.04.2024, kohë kjo e mjaftueshme për përmbushjen e të gjitha detyrave për realizimin e plotë të shërbimit.

Referuar sa më sipër si dhe bazuar në Nenin 22 të kontratës nr. 3324/5 prot., datë 07.03.2023, me objekt: “Sistemi Elektronik për të ruajtur, menaxhuar dhe ndjekur në formë elektronike informacionin e bazuar në dokumenta zyrtare (Letër)”, Drejtoria e Përgjithshme e Qeverisjes Elektronike dhe Inovacionit, me memon Nr.14280/1 prot, datë 08.04.2024 sygjeroi shtyrjen e afatit të kontratës deri në datë 15.04.2024.

Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor, Bashkia e Tiranës vendosi shtyrjen e afatit të përfundimit të dorëzimit të shërbimit deri në dt 15.04.2024.

10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës/Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e shërbimeve:Do të ketë vetëm shtyrje të afatit të kontratës me nr. 3324/5 prot., datë 07.03.2023 pa asnjë ndryshim tjetër përsa i përket natyrës, sasive apo vlerës së shërbimit.

11.Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër: Nuk ndryshon vlera me të cilën është lidhur kontrata.

12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti):Nuk është rasti.

13. Kohëzgjatja e kontratës / Marrëveshjes Kuadër: Data e fillimit të implementimit të detyrave është data e nënshkrimit të kontratës, dhe periudha e zbatimit të kontratës do të jetë 27 (njëzetë e shtatë) muaj nisur nga kjo datë, nga të cilat:

- 3 (tre) muaj për implementimin e sistemit nisur nga data e nënshkrimit të kontratës
- 24 (njëzetë e katër) muaj pas implementimit të sistemit (duke filluar nga data e marrjes në dorëzim) do të jetë periudha e mirëmbajtjes së saj.

dhe afati i ri (nëse është rasti): Afati i ri i vendosur bazuar në lidhjen e Aktmarrëveshjes për realizimin e shërbimit do të jetë duke nisur nga data 08.04.2024 deri në dt. 15.04.2024.

14. Emri dhe adresa e operatorit/ëve Ekonomikë:

Operatori ekonomik “BNT ELECTRONICS” SHPK

Adresa: Tirane Bulevardi Zhan D'ark, Nd.32, Hyrja 16, Kati 2, Ap.1, Tiranë

NUIS: J61817047D

Telefoni: : 0682029370 +35542273666

E-mail: info@bntelectronics.com

15. Data e nënshkrimit të modifikimit: 08.04.2024

16. Burimi i financimit: Rialokuar fondi tek V.K.B Nr. 125 dt 22.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2024”.

17. Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti/enti kontraktor\_\_\_\_\_